

Testimi intelektual

Nëpërmjet testimit intelektual, synohet të vlerësohen niveli i njohurive dhe kulturës së përgjithshme, aftësive për të gjykuar dhe vepruar, aftësitë e përqendrimit të vëmendjes, si dhe niveli i përgjithshëm i inteligjencës.

Testimi intelektual zhvillohet pas kualifikimit në testin e përgatitjes fizike. Ai zhvillohet në mënyrë elektronike në dy pjesë: *testimi i përgjithshëm intelektual* dhe *testimi sipas specialiteteve*, i cili ka si qëllim identifikimin e disa njohurive të domosdoshme për specialitetet në FA.

Testi i përgjithshëm intelektual zhvillohet në fushat e mëposhtme:

- Arsyetim aritmetik
- Njohja e kuptimit të fjalëve
- Të kuptuarit e paragrafëve
- Njohuri matematikore

Në testin e përgjithshëm intelektual, minimumi i pikëve për kualifikim do të jetë **78** pikë. Kandidati që nuk arrin minimumin e pikëve skualifikohet, duke ndërprerë konkurrimin e mëtejshëm. Kontrolli dhe rezultati i testit intelektual bëhet nëpërmjet sistemit elektronik. Renditja bëhet duke filluar nga pikët maksimale.

Pas përfundimit të testit të përgjithshëm, me kandidatët e kualifikuar zhvillohet testi intelektual për specialitetet. *Testimi intelektual* për specialitetet zhvillohet për vlerësimin e njohurive për:

- Shkencat e përgjithshme
- Mekanikën dhe Automatizimin
- Elektronikën dhe Informacionin
- Shërbimet Mekanike

Gjatë testimit për specialitetet kandidati duhet të arrijë një minimum pikësh që të kualifikohet për specialitetin përkatës. Në përfundim të testimit, nëpërmjet sistemit nxirret lista e rezultateve të kandidatëve, duke filluar nga kandidati që ka marrë më shumë pikë deri tek kandidati i fundit.

Vlerësimi për specialitetet bëhet mbi bazën e kombinimit të njohurive të testimit të përgjithshëm intelektual dhe njohurive nga fushat e testimit për specialitetet. Kombinimi varet nga lloji i specialitetit. Ai është i ndryshëm për specialitete të ndryshme.

Kriteret për testimin për specialitetet dhe minimumi i pikëve që kandidatët duhet të arrijnë të përcaktohen në Rregulloren e Testimit, e cila të miratohet nga SHSHP.

Hartimi i testeve, zbatimi i procedurave të testimit për pranimin e kandidatëve për ushtar/detar aktiv në FA, janë përgjegjësi e Qendrës së Personel Rekrutimit, në bashkëpunim me DAPSU, Drejtorinë e Personelit (J1) dhe Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes.